



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 246/19**  
**275/19**  
**278/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Goran Milenković– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi–Referues, z.Blerim Dina–Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operoret Ekonomik: “ArhikoIng OP” – Prishtinë, dhe “Studio Hapësira” & “Taulant” SH.P.K.- Prishtinë dhe N.P.N. “EngIdea” & “SIB BK” SH.P.K. – Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku janë rekomanduar për kontratë Operoret Ekonomik: “Pro Ing&Partners&Engineering Group” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve” me numër të prokurimit: 62500-19-1228-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malishevë, më datën 25.06.2019 mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operoreve: “Arhiko Ing OP” – Prishtinë, ankesa e “Studio Hapësira & Taulant” SH.P.K.- Prishtinë dhe ankesa e N.P.N. “EngIdea” & “SIB BK” SH.P.K. – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve”, me numër të prokurimit: 62500-19-1228-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malishevë.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve”, me numër të prokurimit: 62500-19-1228-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malishevë dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatoreve ekonomik ankues “ArhikoIng OP” – Prishtinë, ankesa e ”Studio Hapësira”&”Taulant” SH.P.K.- Prishtinë dhe OE N.P.N. “EngIdea” & “SIB BK” SH.P.K. – Suharekë, aprovohen pjesërisht si e bazuar, operatorëve ekonomik ankues i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 18.03.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 08.04.2019

Njoftimi për tenderues të pasukseshëm OE “ArhikoIng OP” dt: 20.05.2019

Njoftimi për tenderues të pasukseshëm OE “Eng Idea&SIBBka” dt: 20.05.2019

Njoftimi për tenderues të eliminuar OE “Studio Hapësira” dt: 20.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim OE “ArhikoIng OP” dt: 21.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim OE “Eng Idea&SIBBka” dt: 22.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim OE “Studio Hapësira” dt: 21.05.2019

Vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim dt: 15.05.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 23 dhe 24.05.2019 ka marrë vendim që të refuzohen kërkesat për rishqyrtim si të pa bazuara nga OE. “ArhikoIng OP” – Prishtinë, dhe ”Studio Hapësira”&”Taulant” SH.P.K. – Prishtinë dhe N.P.N. “EngIdea” & “SIB BK” SH.P.K. – Suharekë,



Operatori ekonomik ankues “ArhikoIng OP” – Prishtinë, si palë e kënaqura, kanë deponuar ankesë në OSHP, me datë 27.05.2019 me nr. 246/19, dhe “Studio Hapësira” & “Taulant” SH.P.K.- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.06.2019 me nr. 275/19 dhe N.P.N. “EngIdea” & “SIB BK” SH.P.K. – Suharekë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.05.2019 me nr. 278/19 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve”, me numër të prokurimit: 62500-19-1228-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malishevë, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues për OE. “ArhikoIng OP” – Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 65, 66, dhe 69 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 7
- Nenin 33 të RrUOPP-së
- Autoriteti kontraktues për OE ankues “Studio Hapësira” & “Taulant” SH.P.K.- Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 10, 24, 27, 28, 40, 51, 56, 59, 60, 64, 67 dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- Autoriteti kontraktues për OE ankues N.P.N. “EngIdea” & “SIB BK” SH.P.K. – Suharekë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59.4, 60.1.1, 61, 62 dhe 64.3, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 17.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

**Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “ArhikoIng OP” - Prishtinë.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “ArhikoIng”, njoftohet nga AK-Komuna Malishevë me letrën standarde të tenderuesit të pasuksesshëm, ndërsa në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “ArhikoIngo OP”, pretendon se i rekomanduari për kontratë e ka dorëzuar një kontratë të menaxherit të projektit z. Isak Idrizi, i cili sipas OE ankues është profesor në Universitetin e Shkupit, lidhur me menaxherin në fjalë OE ankues pretendon se i njëjti nuk e ka nënshkruar vet inxhinieri dhe poashtu kërkon që të verifikohen nënshkrimet e gjithë stafit të inxhinierëve me kopje të letrës njoftimit.

Lidhur me pretendimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues, sqaron se të gjitha këto pretendime janë në



kompetence te organeve te hetuesisë dhe nuk janë kompetence lëndore e OSHP-se, për te krahasuar origjinalitetin apo autenticitetin e nënshkrimeve. Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me kontratën e menaxherit te projektit eksperti shqyrtues sqaron se kontrata është sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe lidhur me nënshkrimin e vendosur ne këtë kontrate nuk mund te konstatohet se është bere falls pasi qe siç u sqaruar edhe me lart nuk është ne kompetencë te OSHP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, qe ka të beje me formularin e tenderit te OE te rekomanduar për kontratë, për te cilin pretendon se i njëjti nuk e ka përdorur nënshkrimin e avancuar digjital, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se formulari i dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë i përmban te gjitha te dhënat e nevojshme duke përfshirë nënshkrimet, vulat, ndërsa sa i përket nënshkrimit digjital apo te avancuar ne fund te nenit 399 te RrUOPP-se, është dhënë sqarimi se nuk janë te obligueshme deri ne njoftimin zyrtare nga KRPP-ja.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se anëtari i konzorciumit, i ka dorëzuar certifikatat e biznesit te vjetra dhe sipas OE ankues, nuk janë me valide, eksperti shqyrtues sqaron se certifikatat e vjetra janë valide deri ne Shtator te vitit 2019 sipas udhëzimit administrativ te MTI-se te publikuar ne ueb faqe.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me kontratat dhe referencat e dorëzuara nga i rekomanduari për kontratë, për te cilin pretendon se nuk ka asnjë dëshmi qe punët janë kryer por i ka dorëzuar vetëm kontratat e nënshkruara, eksperti shqyrtues sqaron se është i paqëndrueshëm ky pretendim për faktin se ne ofertën e OE te rekomanduar për kontratë gjenden raportet e pranimi teknik dhe referencat për projektet e përfunduara dhe njëherit eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim nuk ka qene i parashtruar ne kërkesën për rishqyrtim.

Duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me larte eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore te OE ankues “ArhikoIng OP” janë te pabazuar.

#### **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Studio Hapësira” - Prishtinë.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Studio Hapësira”, eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, me arsyetimin se pas ekzaminimit te ofertës financiare rezulton qe çmimi i ndryshuar pas llogaritjes se gabimeve aritmetike, e kalon 2 % e vlerës se ofertës te parapare ne nenin 59 te LPP-se.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit dhe pretendimin e OE ankues se nuk e kemi kaluar pragun prej 2% te gabimeve aritmetike, sqaron se OE ankues ne ofertën e tij financiare ka dhënë totalin e peshuar 1.13 euro.



Gjatë vlerësimit të ofertave AK-ja, përkatësisht komisioni vlerësues ka vërejtur se oferta financiare e OE ankues “Studio Hapësira”, ka gabime aritmetike dhe pas përlllogaritjes komisioni ka konstatuar vlera e përmirësuar e tejkalon 2 % e parapare në nenin 59 të LPP-se, me arsyetimin se në hapje vlera ka qene 1.13 euro, ndërsa pas përmirësimit rezulton të jetë 1.155 euro.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dosjen e tenderit sqaron se në pikën 20.1 të dosjes së tenderit AK-ja ka dhënë sqarimin se: Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. **Çmimi i ofertuar** lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.

Duke u bazuar në sqarimin e lartshënuar AK-ja, gjatë vlerësimit apo llogaritjes së çmimit nuk është dashur ta marr për bazë numrin e tret pas presjes dhjetore, që në rastin konkret ka rezultuar të jetë 1.155, të cilin AK-ja e ka llogaritur gjatë vlerësimit.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, në këtë rast nuk i ka respektuar procedurat e vlerësimit sipas sqarimeve të dhëna në dosje të tenderit. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE ankues “Studio Hapësira” është bazuar për faktin se AK-ja, gjatë vlerësimit duhet të marr për bazë vetëm kriteret e vendosura në dosje të tenderit. Me saktësisht AK-ja, gjatë rivlerësimit të ofertave nuk duhet të marr parasysh asnjë numër pas numrit të dytë pas presjes dhjetore.

#### **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Eng Idea&SIBBka” - Suharekë.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Eng Idea&SIBBka”, njoftohet nga AK-Komuna Malishevë, si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe ofertën e dytë me radhë sipas çmimit.

OE ankues, në ankesën e tij për ofertën e të rekomanduarit për kontratë ka pretendime se ka ofruar ofertë me çmime jo/normalisht të ulët dhe njëherit për të njëjtin pretendim në ankesën e tij e ka paraqitur edhe tabelën sipas rregullores për çmime Jo/Normalisht të ulët, sipas së cilës pragu për të konsideruar ofertë me çmim jo/normalisht të ulët janë ofertat nën vlerën: 1.59 euro.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, gjatë vlerësimit të ofertave nuk i ka zbatuar procedurat e nenit 61 të LPP-se dhe Rregulloren për çmime Jo/Normalisht të ulëta, prandaj ky pretendim i OE ankues është pjesërisht qëndrueshëm, për faktin se sipas nenit 61 të LPP-se, është e drejtë e AK-se që të vlerësojë çmimin e ofruar nga OE, mirëpo fakti që AK-ja nuk i ka zbatuar procedurat e rregullores së lartpërmendur ky pretendim është



pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE “ArhikoIng OP”, ne ofertën e tij ka dorëzuar diplomën e inxhinierit Gjeodet në gjuhë Kroate dhe te njëjtën diplomë nuk e ka përkthyer ne asnjërën nga tri gjuhët zyrtare te paraparë ne LPP, eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim është i qëndrueshëm për faktin se OE “ArhikoIng OP”, ne ofertën e tij e ka dorëzuar diplomën ne gjuhën Kroate te inxhinierit HebibAlili, te papërkthyer ne asnjërën nga tri gjuhët e parapara ne nenin 13 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, AK-ja nuk ka ofruar qasje ne çmimet e ofruara nga OE, eksperti shqyrtues, sqaron se ne baze te shkresave te lendes qasja është aprovuar nga AK-ja, ndërsa fakti se sa ka pasur mundësi te qaset OE ne dokumentet e kërkuara eksperti shqyrtues nuk mund ta konstatoj një fakt te tille. Prandaj i mbetet AK-se qe ta sqaroj këtë situatë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “ArhikoIng OP” te refuzohet si e pa bazuar, ndërsa ankesa e OE-ve ankues “Studio Hapësira” dhe “Eng Idea&SIBBka” të aprovohen si te bazuara, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie të kontratës te anulohet që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatoret ekonomik “ArhikoIng OP” – Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 18.06.2019, kanë njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik OE ankues “Studio Hapësira” & “Taulant” SH.P.K.- Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 18.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik OE ankues N.P.N. “EngIdea” & “SIB BK” SH.P.K. – Suharekë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe përfaqësuesit e operatoreve ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesat e operatoreve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se pare ankuese z. Lekaj deklaroi: Neve na është bere e padrejtë nga eksperti se ne asnjë pikë thotë nuk kemi të drejte ankese, pika e pare dhe Autoriteti Kontraktues i



kanë kërkuar që kompanisë që e ka shpall për fitues t'ia kërkoj nënshkrimet në letërnjoftim nga noteri për arsye se me njëdiplomë të një inxhinieri që nuk gjendet në Kosovë ai mund të merr punën dhe të kryej dikush tjetër, me sa kemi informata menaxheri i kontratës nuk jeton në Kosovë, jep mësim në fakultet në Shkup, është menaxheri i kontratës në fjalë, provat i kemi cekur në ankesë, kompania në fjalë e ka menaxher kontratë, për atë arsye kemi kërkuar nënshkrimet dhe stafin që ka prezantuar. Pika 2. Të dorëzimi elektronik nënshkrimin digjital në jemi bazuar në nenin 33 dhe 33.9, eksperti e ka quajtur këtë nën si të pabazuar që për neve është shkelje sepse ne nuk i shkruajmë nenet dhe jemi bazuar në këtë nën, përveç asaj kompania në fjalë ka ofruar nënshkrim të fotografuar, ku për ne edhe kjo është shkelje. Edhe për nenin 3.12 që obligon OE të kenë përditësimin e të dhënave të tyre Kompania në fjalë nuk e ka numrin identifikues të ri por e ka ofruar të vjetrin. Ne i kemi shfrytëzuar nenet e LPP-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se dytë ankuese. z. Halimideklaroj: Unë pajtohem me mendimin e ekspertit, vetëm kemi njëvërejtje që në ekspertizë nuk është precizuar që a ka apo nuk ka gabime aritmetike, vetëm e ka dhënë vërejtjen e ka precizuar ku çmimi total i peshuar i Autoriteti Kontraktues që është 1.155 decimalja të mos merret për bazë. Në bazë të kalkulimeve të kompanisë së pari Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje, nuk e ka respektuar nenin 20 të DT-së, e dyta Autoriteti Kontraktues nëse ka gabime aritmetikore duhet të dërgoj formularin B49, në këtë rast Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar dhe ka marrë vendim pa mendimin tonë si kompani. Çmimi total i peshuar i ngarkuar i joni është 1.13 ndërsa i korrigjuar nga Autoriteti Kontraktues është 1.55 nëse kullohet diferenca e gabimit aritmetikor është 0.023 euro nëse pjesëtohet me çmimin total të korrigjuar edhe shumëzohet me 100% atëherë gabimi aritmetikor është 1.95% nuk e arrijmë 2% dhe mbas ligjit është e lejuar deri në 2% dhe konsiderojmë që oferta jonë është e përgjegjshme.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se dytë ankuese. z. Ramadanideklaroj: Konsideroj që ankesa e grupit të ekonomisë në 3 pikat është e drejtë në jemi pajtuar me mendimin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim për këtë seancë po ju dorëzoj deklarin në mënyrë të shkruar.

Sa i përket pikës 2. Diplomën e Hebibi Alili do ta le kopje që është në gjuhën kroate e nuk është e përkthyer në gjuhët zyrtare.

Pika 3. e pretendimit të tone që Autoriteti Kontraktues nuk ka lejuar qasje në çmimet e OE-ve duke aluduar që çmimet janë konfidenciale, konsiderojmë një prej shkeljeve që eksperti nuk e ka definuar. Në mungesë të qasjeve në çmime ne kemi të pamundur të dimë as çmimet e fituesit e as të OE-ve të tjerë përfshirë këtu edhe Studio Hapësirën, mirëpo mesa dëgjovakët kalkulimi i përqindjes është shumë i thjeshtë gjë që nuk pajtohem as me ekspertin e as ankuesin Studio Hapësirë, sepse çmimet janë me 2 shifra pas presës dhjetore mirëpo vet peshimi i çmimit me përqindje me të madhe të llogarive jep rezultat me 3 shifra pas presës dhjetore. Ky çmimi peshuar



dhe njësia është €X% prandaj konsideroj qe përqindja është llogari e thjeshte nga çmimi total pas përmasimit të gabimit që është 1.155 1.13 i prezantuar nga OE është 97.88 e vlerës reale çka do të thotë gabimi është 2.16%

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Javori deklaroj: Po ndalem të ankesa e pare OE “Arhiko” ne jemi pajtuar me mendimin e ekspertit në të gjitha pikat për këtë OE, edhe kemi kërkuar nga inxhinieri i kompanisë qe a punon për këtë kompani dhe kam përgjigjen qe me ka dërguar dhe i dorëzoi panelit emrin IsakS Idrizi punon me orar të plotë për kompaninë e rekomanduar.

Pika 2. Studio Hapësira, ne si Autoriteti Kontraktues nuk jemi pajtuar me mendimin e Ekspertit Shqyrtues komisioni i vlerësimit ka qenë profesional dhe ka vërtetuar se OE në fjalë ka bërë gabime aritmetike qe e tejkalojnë 2% të lejuar me LPP. I ngritët çmimi për 2.16 % sa për shkeljen qe tha përfaqësuesi qe nuk e ka respektuar B49 është letër standarde nuk ka pas nevojë sepse është mbi 2% të lejuar, dhe nuk ka nevojë mi dërguar letër standarde.

Pika 3. Tek OE ENG IDEA dhe SIB, ne e kemi vlerësuar si oferte përgjegjëse për kriter të dhënies se kontratës ka qenë çmimi me i ulët. Dhe ofertat që ne kemi shpallur fitues i plotësonte gjitha kërkesat e Autoriteti Kontraktues. Sa për atë që tha qe nuk ka pas qasje nëçmimet e OE-ve, OE në fjalë ankues ka pas qasje në të gjitha dokumentet qe ka dashur ti shoh për veç ato sekrete por çmimin e ka pa.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Basha deklaroj: Sa i përket pretendimeve të “ARHIKO ING”: Pretendime të cilat nuk janë as kompetencë e OSHP-së për faktin se kërkon të bej krahasime të stafit profesional me ID e tyre, po ashtu është i paqëndrueshëm pretendimi në lidhje me Certifikatën e Biznesit dhe kontratat, referencat për OE të rekomanduar për kontratë, sa i përket ofertës “Arhiko” kam sqaruar se i njëjti ka dorëzuar një diplomë i cili nuk është ne asnjërin nga gjuhët zyrtare dhe njëherit është pretendim i OE “ENG IDEA”.

Lidhur me pretendimet e OE “Studio Hapësira”: i cili është eliminuar për gabime mbi 2% Autoriteti Kontraktues gjate përmirësimit ka nxjerr njëshifër prej 1.155 numri i 3-të pas 2 numrave të presës dhjetore nuk duhet të merret parasysh perfektin se Autoriteti Kontraktues ka dhen vet sqarime në DT se numri i 3-të nuk do të merret për bazë në llogaritjen e vlerës së ofertës.

Pretendimet e ENG IDEA : e sqarova se ka pas pretendim me diplomën qe është ne gjuhën kroate dhe mos respektimin procedurave të parapara në nenin 61 të LPP-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së së rekomanduar për kontratë z. Fetoshi deklaroj: Desha vetëm sa i përket pretendimet e ngritura në lidhje me nënshkrimin e inxhinierit e inkurajojmë përfaqësuesin Ankues dhe se cilin që dyshon ne këto nënshkrime ti drejtohen organeve të hetuesisë dhe njëkohësisht e kundërshtojmë Ekspertin Shqyrtues ne lidhje me llogarinë e gabimeve aritmetikore të OE “Studio Hapsira” për shkak se nuk është bërë nëmënyrën dhe formën e duhur.



Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese deklaroj: Kërkojmë që të aprovohet si e bazuar ankesa jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese deklaroj: Kërkojmë që të aprovohet si e bazuar ankesa jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së tretë ankuese deklaroj: Kërkojmë që të aprovohet si e bazuar ankesa jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë që ankesat e OE-ve ti hudhe si të pabazuara, vendimin e Autoriteti Kontraktues ta lë në fuqi.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertëve të OSHP-së, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues “ArhikoIng OP” - Prishtinë.

Lidhur me pretendimin OE ankues “ArhikoIngo OP”, se i rekomanduari për kontratë e ka dorëzuar një kontratë të menaxherit të projektit z. IsakIdrizi, i cili sipas OE ankues është profesor në Universitet të Shkupit, lidhur me menaxherin në fjale OE ankues pretendon se i njëjti nuk e ka nënshkruar vet inxhinieri dhe poashtu kërkon që të verifikohen nënshkrimet e gjithë stafit të inxhinierëve me kopje të letërnjoftimit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se të gjitha këto pretendime janë në kompetencë të organeve të hetuesisë dhe nuk janë kompetencë lëndore e OSHP-se, për të krahasuar origjinalitetin apo autenticitetin e nënshkrimeve. Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me kontratën e menaxherit të projektit paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kontrata është sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe lidhur me nënshkrimin e vendosur në këtë kontratë nuk mund të konstatohet se është bërë fals pasi që siç u sqaruar edhe më lart nuk është në kompetencë të OSHP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, që ka të bëjë me formularin e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë, për të cilin pretendon se i njëjti nuk e ka përdorur nënshkrimin e avancuar digjital. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se formulari i dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme duke përfshirë nënshkrimet, vulat, ndërsa sa i përket nënshkrimit digjital apo të avancuar në fund të nenit 39 të RrUOPP-se, është dhënë sqarimi se nuk janë të obligueshme deri në njoftimin zyrtar nga KRPP-ja.



Sa i përket pretendimit të OE ankues, se anëtar i konzorciumit, i ka dorëzuar certifikatat e biznesit të vjetra dhe sipas OE ankues, nuk janë me valide. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se certifikatat e vjetra janë valide deri në Shtator të vitit 2019 sipas udhëzimit administrativ të MTI-se të publikuar në ueb faqe.

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me kontratat dhe referencat e dorëzuara nga i rekomanduari për kontratë, për të cilin pretendon se nuk ka asnjë dëshmi që punët janë kryer por i ka dorëzuar vetëm kontratat e nënshkruara. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se është i paqëndrueshëm ky pretendim për faktin se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë gjenden raportet e pranimi teknik dhe referencat për projektet e përfunduara dhe njëherit sqarojmë se ky pretendim nuk ka qenë i parashtruar në kërkesën për rishqyrtim.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep sqarime lidhur me pretendimet e OE "Studio Hapësira" - Prishtinë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues "Studio Hapësira", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, me arsyetimin se pas ekzaminimit të ofertës financiare rezulton që çmimi i ndryshuar pas llogaritjes së gabimeve aritmetike, e kalon 2 % e vlerës së ofertës të parapare në nenin 59 të LPP-se.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se, lidhur me arsyen e eliminimit dhe pretendimin e OE ankues se nuk e kemi kaluar pragun prej 2% të gabimeve aritmetike, sqarojmë se OE ankues në ofertën e tij financiare ka dhënë totalin e peshuar 1.13 euro. Gjatë vlerësimit të ofertave AK-ja, përkatësisht komisioni vlerësues ka vërejtur se oferta financiare e OE ankues "Studio Hapësira", ka gabime aritmetike dhe pas përllogaritjes komisioni ka konstatuar vlera e përmirësuar e tejkalon 2 % e parapare në nenin 59 të LPP-se, me arsyetimin se në hapje vlera ka qenë 1.13 euro, ndërsa pas përmirësimit rezulton të jetë 1.155 euro.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pasi është analizuar dosjen e tenderit sqarojmë se në pikën 20.1 të dosjes së tenderit AK-ja ka dhënë sqarimin se: Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshijnë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Andaj duke u bazuar në sqarimin e lartshënuar AK-ja, gjatë vlerësimit apo llogaritjes së çmimit nuk është dashur ta merr për bazë numrin e tret pas presës dhjetore, që në rastin konkret ka rezultuar të jetë 1.155, të cilin AK-ja e ka llogaritur gjatë vlerësimit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se AK-ja, në këtë rast nuk i ka respektuar procedurat e vlerësimit sipas sqarimeve të dhëna në dosje të tenderit. Prandaj, vlerësojmë se ankesa e OE ankues "Studio



Hapësira” është bazuar për faktin se AK-ja, gjatë vlerësimit duhet ti marr për bazë vetëm kriteret e vendosura në dosje të tenderit. Me saktësisht AK-ja, gjatë rivlerësimit të ofertave nuk duhet të marr parasysh asnjë numër pas numrit të dytë pas presjes dhjetore.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE “Eng Idea&SIBBka” - Suharekë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se OE ankues “Eng Idea&SIBBka”, njoftohet nga AK-Komuna Malishevë, si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe ofertën e dytë me radhë sipas çmimit.

OE ankues, në ankesën e tij për ofertën e të rekomanduarit për kontratë ka pretendime se ka ofruar ofertë me çmime jo/normalisht të ulët dhe njëherit për të njëjtin pretendim në ankesën e tij e ka paraqitur edhe tabelën sipas rregullores për çmime Jo/Normalisht të ulët, sipas se cilës pragu për të konsideruar ofertë me çmim jo/normalisht të ulët janë ofertat nën vlerën: 1.59 euro.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se AK-ja, gjatë vlerësimit të ofertave nuk i ka zbatuar procedurat e nenit 61 të LPP-së dhe Rregulloren për çmime Jo/Normalisht të ulëta, prandaj ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i qëndrueshëm, për faktin se sipas nenit 61 të LPP-së, është e drejtë e AK-së që të vlerësojë çmimin e ofruar nga OE, mirëpo fakti që AK-ja nuk i ka zbatuar procedurat e rregullores së lartpërmendur ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE “ArhikoIng OP”, në ofertën e tij ka dorëzuar diplomën e inxhinierit Gjeodet në gjuhë Kroate dhe të njëjtën diplomë nuk e ka përkthyer në asnjërën nga tri gjuhët zyrtare të parapara në LPP. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se ky pretendim është i qëndrueshëm për faktin se OE “ArhikoIng OP”, në ofertën e tij e ka dorëzuar diplomën në gjuhën Kroate të inxhinierit Hebib Alili, të pa përkthyer në asnjërën nga tri gjuhët e parapara në nenin 13 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se AK-ja nuk ka ofruar qasje në çmimet e ofruara nga OE, paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se në bazë të shkresave të lëndës qasja është aprovuar nga AK-ja, ndërsa fakti se sa ka pasur mundësi të qaset OE në dokumentet e kërkuara .

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.



Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK –“Komuna Malishvë” –Malishevë,  
1x1 OE – “ArhikoIng OP” – Prishtinë,  
1x1 OE – Studio Hapësira”&”Taulant” SH.P.K.- Prishtinë,  
1x1 OE–N.P.N.“EngIdea” & “SIB BK”SH.P.K. – Suharekë,  
1x1 Arkivës së OSHP-së;  
1x1Për publikim në web- faqe të OSHP-së.